**Republika e Kosovës**
Republika Kosova
Republic of Kosovo

**Komuna e Kaçanikut**
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

**Drejtoria e Arsimit**

01 Nr. 610/01 - 21781/26

**Datë, 14.08.2026**

Në bazë të Ligjit nr. 04/L- 032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Udhëzimit Administrativ nr. 22/2013 për numrin maksimal të nxënësve për klasë dhe raporti mësimdhënës nxënës, Drejtoria e Arsimit shpallë:

## KONKURS

Për regjistrimin e nxënësve në klasën e dhjetë (10) në Gjimnaz dhe Institucionin e Arsimit dhe Aftësimit Profesional (IAAP) për vitin shkollor **2026/2027**

1. Kushtet e përgjithshme për regjistrimin e nxënësve të rregullt
   Për regjistrimin e nxënësve në klasën e 10-të, të gjimnazeve dhe të IAAP-ve, për vitin shkollor **2026/27**, mund të konkurojnë kandidatët, të cilët e kanë mbaruar arsimin e obligueshëm dhe nuk janë më të vjetër se 17 vjeç. Nxënësit, të cilët e kanë mbaruar klasën e 9- të jashtë Kosovës, obligohen ta bëjnë nostrifikimin e dëftesave në MASH dhe pastaj të konkurojnë për regjistrim.
2. Dokumentet e nevojshme për konkurim

Nxënësit për të konkurruar për regjistrim në klasën e 10-të në Gjimnaz dhe IAAP, duhet të paraqesin këto dokumente:

- **Fletëparaqitja (e cila merret në shkollën në të cilën konkuron)**
- **Dëftesa origjinale për kryerjen e shkollës së mesme të ulët (6-9) dhe**
- **Certifikata e lindjes.**

**Afati i paraqitjes së dokumenteve dhe shpallja e rezultateve**

Paraqitja e dokumenteve për Gjimnaz dhe IAAP për vitin shkollor **2026/2027**, bëhet më datën **17, 18 dhe 19 gusht 2026,** në lokalet e shkollës amë, ku nxënësi dëshiron të regjistrohet duke filluar nga ora **08.00-16.00**.

Rezultatet për pranimin e nxënësve shpallen në shkollat përkatëse me datën **19.08.2026**. Kthimi i dokumenteve për nxënësit, të cilët nuk janë pranuar do të bëhet prej **20 gusht 2026.** Kandidati i refuzuar dhe i cili dyshon se i janë shkelur kriteret e regjistrimit ka të drejtë, brenda 24 orëve, nga koha e shpalljes së rezultateve t'i paraqes ankesë drejtorisë së shkollës, Drejtorisë Komunale të Arsimit dhe në raste të jashtëzakonshme edhe MASH, Komisionit për ankesa.

A. Kriteret për regjistrim

Nxënësi për regjistrim në klasën e 10-të duhet t'i plotësojë këto kritere:

| | | |
|---|---|---|
| **1. Suksesi nga shkollimi i obliguar** | **(40%)** | **40 pikë** |
| **2. Suksesi nga lëndët prioritare në test** | **(20%)** | **20 pikë** |
| **3. Numri i pikëve nga testi** | **(40%)** | **40 pikë** |

**Nxënësi maksimalisht mund t'i fitojë 100 pikë.**

**4. Kriteri i lëndëve prioritare nga suksesi për gjimnaze është, që mesatarja e këtyre lëndëve të jetë 4** (Së pari llogaritet mesatarja e lëndëve veç e veç, pastaj mesatarja e mesatareve të atyre lëndëve).

5. **Kriteri i lëndëve prioritare nga testi për gjimnaze dhe shkolla të mesme është minimumi 40% i pikëve nga ato lëndë.**

**Shih: Njoftimin e datës 29.06.2026, për kushtet, kriteret dhe afatet e regjistrimit të nxënësve në klasën e X-të, për vitin shkollor 2026-2027.**

**IAAP ”Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka” – Kaçanik**

| Komuna | Shkolla | Drejtimi | Profili | | | Vende të lira |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Kaçanik** | IAAP "Feriz Guri & Vëllezërit .Çaka" | Makineri, prodhim dhe ndertimtari,Elektroteknikë | Instalues elektrik ( **DUAL**) | | | 1 |
| | | | Instalues i ngrohjes, klimatizimit, ujesjellesit | | | 23 |
| | | | Automekanik ( **DUAL**) | | | 4 |
| | | | Metalpunues ( **DUAL**) | | | 15 |
| | | | Trafik rrugorë | | | 19 |
| | | Teknologji e informacionit dhe komunikimit | Informatikë | | | 9 |
| | | Juridik | Asistent juridik | | | 15 |
| | | Ekonomi | Tregti me pakicë dhe shumicë ( **DUAL**) | | | 0 |
| | | | **Gjithsej** | | | **86** |

**Gjimnazi "Skënderbeu" - Kaçanik**

| Nr. | DREJTIMI | Nr. i paraleleve | Nr. i nxënësve (vende të lira) |
|---|---|---|---|
| 1. | **Shkenca Natyrore** | - | 55 |
| 2. | **Shkenca Shoqërore- Gjuhësore** | - | 50 |
| 3. | **Gjithsej** | - | **105** |

Drejtori i DKA- së
z. Gazmend Bunjaku